



Datë: 31.07.2025

Numër Protokolli: 5189/2025

A.nr.1044/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1044/2025, të datës 02.06.2025, të parashtruar nga ankuesja A.H, kundër organit të punësimit Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1044/2025, e datës 02.06.2025, e parashtruar nga ankuesja A.H.

A r s y e t i m

Ankuesja, A.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 02.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 30.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, lidhur me rezultatet e testit me shkrim, për procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00017346, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit të Arkivit Ndër komunal*” të Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, me datë 24.03.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017346, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit të Arkivit Ndër komunal*” të Prizrenit, me afat aplikimi nga data 25.03.2025 deri më datë 23.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit mbi rezultatet e testi me shkrim të datës 30.05.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore e Arkivave të Kosovës, rezulton se e njëjta nuk ka kaluar testin me shkrim.

Andaj, kundër Njoftimit mbi rezultatet e testi me shkrim të datës 30.05.2025 ankuesja me datë 02.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se kandidati që ka kaluar testin me shkrim nuk përmbush kriteret e konkursit, dhe se e njëjta ka mbi 20 vite përvojë pune si zyrtare e arkivës, rrjedhimisht kërkon pezullimin e procesit të përzgjedhjes, rishqyrtimin e rezultatit të testit me shkrim dhe verifikimi e përvojës së punës së kandidatëve tjerë.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 44 paragrafi 10 ku përcaktohet se: *12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 02.05.2025, kundër Njoftimit të datës 30.05.2025, lidhur me rezultatit të testit me shkrim, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës,

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1044/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.H;
- Udhëheqësit të Divizioni të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.